



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 04.04.2023, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “ECO - ELB” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali i përpunimit të mbetjeve urbane, me kapacitet të instaluar 2850 kW.
2. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 20.03.2023, 23.03.2023 dhe 27.03.2023.
3. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.04.2018.
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199, datë 03.09.2018.
5. Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
6. Mbi licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier.
7. Mbi licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
8. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s 58, datë 31.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Terfoja” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Terfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kW”.
9. Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “M&K Energy Trading CO” sh.p.k..

10. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “AEE” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 210, datë 27.09.2018.